

Sali KADRIA

**ARSIMI KOMBËTAR NË TERRITORET SHQIPTARE QË
NDODHESHIN NËN OKUPIMIN AUSTRO-HUNGAREZ
(1916-1918)**

Abstrakt:

Synimi i këtij punimi është të paraqesë zhvillimin e arsimit shqiptar në vitet 1916-1918. Studimi i kontributit të dhënë nga Austro-Hungaria për zhvillimin e arsimit kombëtar shqiptar, është një mundësi e mirë për të kuptuar më qartë zhvillimin kulturor të shqiptarëve gjatë kësaj periudhe. Punimi do të trajtojë në mënyrë sintetike disa çështje që lidhen me zhvillimin e arsimit në territoret shqiptare të okupuara nga Austro-Hungaria, si: kontributi i Austro-Hungarisë në përgatitjen dhe botimin e teksteve shkollore për shkollat shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe viset shqiptare në Mal të Zi; ngritja e strukturës së sistemit arsimor në territorin e Shqipërisë të okupuar nga Austro-Hungaria; hapja e shkollave fillore në të gjitha trojet shqiptare ku kishte ndërtesa të përshtatshme dhe mësues të aftë për zhvillimin e mësimi; hapja e kurseve të shpejta pranë shkollave normale për përgatitjen e mësuesve shqiptarë; dërgimi i të rinjve shqiptarë për të studiuar në universitetet e Austrisë dhe të Hungarisë; ngritja dhe funksionimi i këshillave shkollore lokale, në të cilat merrnin pjesë njerëzit më të kulturuar dhe më me ndikim, me synim, rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të frekuentimit të nxënësve në shkollat e hapura, si dhe përmirësimin e mirëmbajtjes së ndërtesave të shkollave. Trajtimi i

politikës së ndjekur nga Austro-Hungaria në drejtim të zhvillimit të arsimit shqiptar në këto vite, ka rëndësi gjithashtu për kuptuar drejtë edhe disa aspekte të tjera, si: qëndrimin që mbajti Austro-Hungaria ndaj çështjes kombëtare shqiptare; synimin e Monarkisë Dualiste për t'i parë shqiptarët si një entitet kombëtar. Po kështu, kontributi i Austro-Hungarisë në fushën kulturore, duhet parë në një plan më të gjerë, duke e krahasuar atë me atë të fuqive të tjera ndërluftuese të pranishme në Shqipëri në vitet 1916-1918.

Fjalët kyç: *Arsim kombëtar, shkolla shqipe, tekste shkollore, Austro-Hungaria, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi.*

Prania austro-hungareze në Shqipëri gjatë viteve 1916-1918 është një çështje, për të cilën është folur e shkruar nga studiues shqiptarë dhe të huaj. Me përjashtim të disa zërave të paktë, që janë shprehur se periudha e okupimit austro-hungarez ishte një periudhë e rëndë për shqiptarët dhe se Austro-Hungaria ndoqi thjesht interesat e saj në trojet shqiptare; nga studiuesit në përgjithësi, pranohet ndikimi pozitiv që pati prania austro-hungareze në zhvillimin e shqiptarëve gjatë këtyre viteve. Prandaj duhet theksuar se, edhe nëse Austro-Hungaria hiqej sikur ishte në mbrojtje të shqiptarëve, në të vërtetë, interesat e saj gjeopolitike në Ballkan përkonin me ato të shqiptarëve. Për këtë shkak, Vjena nuk mund t'i lëshonte shqiptarët në duart e armiqve të përbashkët.¹

Nëse kjo periudhë historike shihet me kujdes, përpjekjet e autoriteteve austro-hungareze u përqendruan kryesisht në “aksionin shkollor”; standardizimin e gjuhës shqipe; krijimin e një administrate efikase; ndërtimin e një rrjeti të gjerë transporti në viset shqiptare dhe në numërimin e popullsisë. Kësaj here në

¹ “Kaprolli i Kaçanikut”, *Posta e Shqypnies*, nr. 57, Shkodër, 23 qershor 1917, 2.

trajtesën tonë do të përqendrohemi vetëm në përpjekjet për zhvillimin e arsimit shqiptar gjatë kësaj periudhe.

Pse autoritetet austro-hungareze i kushtuan rëndësi zhvillimit të arsimit?

Pas hyrjes së trupave austro-hungareze në Shqipëri, administrata ushtarake i shtroi vetes detyrën që, pavarësisht vështirësive të shumta që mund të dilnin përpara, ajo do ta rindëronte arsimin shqiptar që nga themeli.²

Së pari, drejtuesit e shtetit austro-hungarez u fokusuan në “aksionin shkollor”, pasi ata e konsideronin Shqipërinë si “vend mik i okupuar” në rrethana lufte³ [Besetztes Freundesland - S. Kadria]. Sipas platformës politike të qeverisë austro-hungareze, populli shqiptar duhej të trajtohej si një komb mik, neutral dhe pro austriak.⁴

Së dyti, drejtuesit e Perandorisë Austro-Hungareze mendonin se për një vend dhe popull si shqiptarët, që sapo kishte shpallur pavarësinë, ndihma më e efektshme ishte investimi në aspekte të zhvillimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të tij, siç ishte arsimiti.

Së treti, nga mesi i shek. XIX e në vijim, Vjena kishte punuar pa ndërprerje për zhvillimin e arsimit në trojet shqiptare.

² *Haus - Hof und Staats Archiv, Wien Politisches Archiv Albanien*, (më tej: *HHSTA, PA, A*) në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*) Vj. 28-61, Relacion nr. 119 me titull: “Arsimi në Shqipëri” i gjeneralit të këmbësisë Koenen-Horak pranë Korpskomandës XIX në Shqipëri, drejtuar Kryekomandës së ushtrisë austro-hungareze, Shkodër, 17 janar 1918.

³ *AIH, A. IV-73*, Mariano San Nicolo, *Administrimi i Shqipërisë nga trupat austro-hungareze*, 2.

⁴ *HHSTA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 28-2-232, Shtojca e shkresës Nr. 4340, Amendamenti. Direktivat politike për administratën e Shqipërisë, Vjenë, 14 shtator 1918.

Prandaj përpjekjet e saj në këtë drejtim edhe gjatë këtyre viteve nuk ishin tjetër, veçse vazhdim i politikës së saj tradicionale.

Së fundmi, gjatë viteve 1916-1918, në territorin e Shqipërisë, Austro-Hungaria u ndesh me një lloj konkurrence me Francën dhe Italinë në fushën e arsimit.⁵ Prandaj, për të ruajtur besimin e shqiptarëve, Vjena ishte e detyruar që të bënte më tepër se fuqitë e tjera rivale në këtë drejtim.⁶

Çfarë ndryshimesh ndodhën në arsimin shqiptar?

Arritja më e shënuar e shqiptarëve që ndodheshin në zonën e okupimit austro-hungarez gjatë kësaj periudhe, ishte krijimi i organeve drejtuese arsimore efikase dhe me karakter kombëtar. Në gusht të vitit 1916, në kuadër të administratës qendrore, u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit në Shkodër, nën drejtimin e Luigj Gurakuqit.⁷ Në varësinë e saj ishin tri drejtori arsimore, përkatësisht:

- Drejtoria e Arsimit të Bezirkut të Shkodrës, e cila mbulonte të gjitha shkollat e Shqipërisë së Veriut deri në Krujë në skajin jugor të këtij rajoni. Gjergj Pekmezi u emërua fillimisht drejtor i kësaj drejtorie, por pasi mori përsipër detyrën e drejtimit të Komisionit Letrare, në vend të tij, si drejtues i arsimit u emërua Mati Logoreci.
- *Drejtorja e Arsimit të Bezirkut të Tiranës*, e cila mbulonte shkollat e rajonit të Shqipërisë së Mesme, me drejtor Hafiz Ali Korçën, i cili më vonë u zëvendësua nga Sotir Peci.

⁵ Ilir Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore (Zona e pushtimit austro-hungarez) 1916-1918*, Tiranë: Neraida, 2001, 26.

⁶ I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 26.

⁷ *HHSTA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 27-1-108, Aneks për raportin e konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral mbi arsimin e Shqipërisë gjatë muajit prill 1917, drejtuar kontit Ottokar Czernin, Shkodër, 17 qershor 1917.

- *Drejtoria e Arsimit të Beratit*, e cila mbulonte shkollat e Beratit, Fierit dhe Lushnjës me drejtor Sali Gjukën.⁸

Në krye të administratës shkollore u vendosën personalitete të arsimit shqiptar dhe figura të shquara atdhetare, si Luigj Gurakuqi, Sali Gjuka, Sotir Peci, Sali Nivica, Mati Logoreci, Dervish Hima, Aleksandër Xhuvani, Sali Çeka e të tjerë.⁹

Një hap në drejtimin e duhur për zhvillimin e arsimit shqiptar në zonën e okupimit austro-hungarez ishte miratimi i një sërë rregulloresh për organizimin dhe funksionimin e arsimit shqiptar. Me propozim të Luigj Gurakuqit, më 20 shtator 1916, nga Komanda e Përgjithshme e trupave austro-hungareze në Shqipëri u miratua “Organizimi i Përkohshëm i Shkollave shqipe”, e cila u njoh me emrin “Rregullorja e shkollave”. Ky ishte akti i parë normativ më i plotë i organizimit të arsimit shqiptar.¹⁰

Sipas kësaj rregulloreje, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit me qendër në Shkodër i paraqiste Korpuskomandës austro-hungareze në Shqipëri listën e vendeve ku mund të hapeshin shkolla në fillim të çdo viti shkollor; numrin e klasave që do të kishte çdo shkollë; numrin e personelit mësimor që ishte në gjendje të jepte mësim; lëndët që do të zhvilloheshin në shkolla, si dhe planet mësimore për shkollat fillore.¹¹

⁸ *Shqipëria më 1937*, Tiranë: Kristo Luarasi, 1937, 159; I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 42-48.

⁹ I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 29.

¹⁰ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-15-1565*, Raport i Komandës eprorë, drejtuar Guvernatoratit të Përgjithshëm Ushtarak austro-hungarez në Beograd, 10 korrik 1916; “Organizimi i Përkohshëm i Shkollave shqipe-Shkodër, 18 Dhetuer 1916”, *Posta e Shqipërisë*, nr. 5, Shkodër, 20 dhjetor 1916, 4; I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 36.

¹¹ I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 36.

“Rregullorja e shkollave” parashikonte që arsimit fillor në qytete të ishte i detyrueshëm për djemtë e moshës 7 deri në 12 vjeç.¹² Ndërkohë që për prindërit, të cilët nuk pranonin t’i dërgonin fëmijët e tyre në shkollë, parashikoheshin sanksione.¹³ Gjuha e mësimin në shkollat fillore ishte shqipja, ndërsa gjuha gjermane fillonte të mësohej në klasat e larta.

Arritje me rëndësi ishte krijimi i një rrjeti të gjerë shkollash, që shtrihej nga qendrat kryesore urbane deri në fshatrat më të largëta të vendit. Autoritetet arsimore ndërtuan një strukturë të rregullt arsimore. Duke marrë parasysh kushtet e vendit, mungesën e mësuesve të arsimuar, shkollave dhe mjeteve mësimore, u vendos që shkollat fillore në katunde të kishin nga një deri në tri klasë, ndërsa në qytete deri në pesë klasë. Në fakt, shumica e shkollave në katunde ishin me nga një klasë. Përveç shkollave fillore, në qytetet, ku kishte nxënës të përgatitur, u vendos që të hapeshin edhe shkolla qytetëse [bürgererschule - S. Kadria], të cilat kishin një klasë më tepër se shkollat fillore. Shkolla qytetëse pati në Shkodër dhe në Elbasan, por duhet pranuar se ato nuk arritën të konsolidoheshin.¹⁴

¹² HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 27-1-108, Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral mbi arsimin e Shqipërisë gjatë muajit prill 1917, drejtuar kontit Ottokar Czernin, Shkodër, 17 qershor 1917; “Lajme vendit. Këshilli shkollues i Shkoders”, *Posta e Shqipërisë*, nr. 33, Shkodër, 31 mars 1917, 3-4; “Kumtim. Detyra e të ndjekunit të shkollës. Drejtorija e Arsimit të Shkodrës, Nr. 713/I”, *Posta e Shqipërisë*, nr. 78, Shkodër, 14 shtator 1918, 4.

¹³ HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-15-1565, Raport i Komandës eprore, drejtuar Guvernatoratit të Përgjithshëm Ushtarak austro-hungarez në Beograd, 10 korrik 1916; “Organizimi i Përkohëshëm i Shkollave shqipe-Shkodër, 18 Dhetuer 1916”, *Posta e Shqipërisë*, nr. 5, Shkodër, 20 dhjetor 1916, 4; I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 36.

¹⁴ *Shqipëria më 1937*, Tiranë: Kristo Luarasi, 1937, 159; I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 57, 72, 74.

Gjatë viteve 1916-1918, nga ana e drejtuesve të arsimit u ndërtua një sistem arsimor funksional. Autoritetet arsimore dispononin të dhëna të sakta për kohën e fillimit të punës së mësuesve, trajtimin e tyre financiar,¹⁵ largimet pa leje të mësuesve nga shkolla,¹⁶ akomodimin e tyre në shkolla apo në shtëpi të marra me qira qoftë edhe në fshatrat më të largëta të një rajoni.¹⁷ Për zhvillimin e arsimit edhe në krahinat më të thella të vendit, administrata arsimore e vendit mori përsipër të mbulonte shpenzimet e udhëtimit të mësuesve të transferuar.¹⁸

Studimet e kryera për gjendjen e arsimit në Shqipëri gjatë viteve 1916-1918, si dhe burimet arkivore austro-hungareze dëshmojnë se në territorin e Shqipërisë së okupuar nga forcat austro-hungareze u hapën rreth 200 shkolla, shifër e cila natyrisht që ndryshon sipas viteve.¹⁹ Nëse hedhim një vështrim mbi numrin e shkollave sipas shtrirjes gjeografike të tyre, arrihet në përfundimin se gjatë kësaj periudhe, numri më i madh i shkollave u hap në qarkun e Tiranës (98 shkolla) dhe në atë të Beratit (93 shkolla). Nga të gjitha këto shkolla, 15 ishin të

¹⁵ Arkivi Qendror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 271, Viti (më tej: V) 1917, Dosja (më tej: D) 9, fl. 48, Shkresë e Pleqësisë së katundit Muriqan drejtuar drejtorit të Krahinës Dumre, 17 mars 1917.

¹⁶ *AQSH*, F. 271, V. 1917, D. 9, fl. 45, Shkresë e drejtorit të Shpatit H. Plangarica drejtuar Nënprefekturës së Elbasanit, Shpat 21 janar 1917.

¹⁷ *AQSH*, F. 271, V. 1917, D. 9, fl. 129, Shkresë e Këshillit të pleqësisë së katundit Lleshan, drejtuar Drejtorisë së Shpatit, Lleshan, 8 shkurt 1917.

¹⁸ *AQSH*, F. 271, V. 1917, D. 9, fl. 55, Shkresë e Sotir Pecit, drejtuar Nënprefekturës Elbasan, Tiranë, 23 nëntor 1917.

¹⁹ *HHSTA*, PA, A, në *AIH*, Vj. 27-1-108, Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral mbi arsimin e Shqipërisë për muajin prill 1917, drejtuar kontit Ottokar Czernin, Shkodër, 17 qershor 1917; *HHSTA*, PA, A, në *AIH*, Vj. 27-1-109, Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar kontit Czernin, Shkodër, 17 qershor 1917; Gj. Fishta, “Ushtria austro-ungare e të mkamunt e Shqypnis”, *Posta e Shqypniës*, nr. 13, Shkodër, 23 janar 1918, 1.

përziera dhe 5 shkolla për vajza. Në këto institucione arsimore jepnin mësim 381 mësues dhe 11 mësuese.²⁰

Gjatë kësaj kohe, në qytetet e Beratit e të Shkodrës u hapën shkolla të mbrëmjes, të cilat ishin kurse për mësimin e gjuhës shqipe në të shkruar e lexuar.²¹ Interesimi dhe kujdesi i autoriteteve austro-hungareze për fëmijët që ndiqnin shkollat fillore arriti deri në atë shkallë, sa në vitin 1918 ato filluan kontrollin e rregullt periodik mjekësor të nxënësve të shkollave në qytetet kryesore të vendit.²²

Për të plotësuar nevojat që kishte vendi për mësues të arsimuar, në pranverë të vitit 1917 u vendos hapja e shkollave normale në Elbasan dhe në Shkodër sipas modelit të Normales së Elbasanit të vitit 1909. Për nxënësit që vinin nga qytete të tjera shqiptare, Komanda Ushtarake austro-hungareze vendosi dhënien e bursave në shumën 30-60 korona austro-hungareze për çdo muaj,²³ ndërsa nxënësve, të cilët ndodheshin në vështirësi

²⁰ HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 28-61, Relacion nr. 119 me titull: “Arsimi në Shqipëri” i gjeneralit të këmbëtorisë Koenen-Horak pranë Korpskomandës XIX në Shqipëri, drejtuar Kryekomandës së ushtrisë, Shkodër, 17 janar 1918; I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 72.

²¹ “Lajme vendit. Shkollë mramjet mbi gjuhë shqype”, *Posta e Shqypnjes*, nr. 16, Shkodër, 2 shkurt 1918, 3; I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 75.

²² HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 28-78, Raport i administrativ i konsullit të Përgjithshëm Kral për muajin qershor 1918, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, qershor 1918.

²³ I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore...*, 79; HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 27-1-108, Aneks për raportin e konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral mbi arsimin e Shqipnisë për muajin prill 1917, drejtuar kontit Ottokar Czernin, Shkodër, 17 qershor 1917; “Pjesa zyrtare. Urdhime të ma të naltës Komandë në Shqipëri. E. V. Nr. 683/III. Shkollat Normale nd’Elbasan e ndë Shkodrë”, *Posta e Shqypnjes*, nr. 32, Shkodër, 28 mars 1917, 4.

ekonomike, u jepej një bursë në shumën nga 60 deri në 100 korona austro-hungareze në muaj.²⁴

Pranë shkollave normale në Shkodër dhe në Elbasan u ngritën kurse të shpejta për kualifikimin e mësuesve, të cilët nga inspektimet e kryera rezultonte se nuk kishin nivelin e duhur arsimor. Gjatë muajve të verës, mësuesve iu dha mundësia që të kryenin kurset e lartpërmendura për përmirësimin e aftësisë së tyre në fushën e mësimdhënies. Në të kundërt, autoritetet arsimore ishin të detyruara të merrnin vendim për largimin e mësuesve të paaftë, të cilët përbënin thjesht një barrë për buxhetin financiar të vendit.²⁵

Duke e parë në plan krahasues, numrin e shkollave të hapura në harkun kohor 1916-1918, konstatohet se në vitin 1918 pati një rënie të numrit të shkollave në raport me ato të hapura në vitin shkollor 1916-1917. Kjo ndodhi për shkak se, me kalimin e viteve, u pa se në Shqipëri kishte mungesa të mëdha në mësues të kualifikuar, si dhe në objekte shkollore.²⁶

Megjithatë, në botimin me titull “Shqipëria më 1937”, që u publikua me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ndër të tjera theksohej se gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore, numri i shkollave të hapura jo vetëm që nuk mund të krahasohej me atë të kohës së shkurtër të vetëqeverimit (1912-1914), por ai ishte më i madh në krahasim edhe me numrin e shkollave të viteve ‘30.²⁷

²⁴ HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-2-213, Shkresë nr. 683/ III e nënkolonel Myrdacz, drejtuar Korpskomandës XIX, 23 mars 1917.

²⁵ HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 27-1-111, Relacion i Korpskomandës XIX lidhur me kurset normale për mësues, Shkodër, 17 qershor 1917; “Lajme vendit. Shkollë me rende të shpejta për mësues”, *Posta e Shqypnies*, nr. 64, Shkodër, 18 korrik 1917, 3.

²⁶ HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 27-1-110, Raport i konsullit të Përgjithshëm Kral për organizimin provizor të arsimit shqiptar, Shkodër, 17 qershor 1917.

²⁷ *Shqipëria më 1937*, Tiranë: Kristo Luarasi, 1937, 159.

Natyrisht që hapja dhe mbajtja e shkollave lidhej, para së gjithash, me financimin e tyre. Sipas një raporti të vitit 1917, që konti Frigyes Szapáry i paraqiste Këshillit të Ministrave të Hungarisë, thuhej se vetëm për vitin arsimor 1916-1917, “aksioni shkollor e ngarkonte buxhetin* me një shumë të konsiderueshme prej 148 000 koronash [shumë që sot është e barabartë me vlerën e 458 512 dollarëve amerikanë - S. Kadria], e cila pritej që të rritej, pasi buxheti shqiptar [për arsimin] ka tendencë rritëse”.²⁸

Gjatë kësaj periudhe, po ashtu u vendos që të dërgoheshin në Austro-Hungari, për të studiuar në degë të ndryshme civile, një numër prej 84 djemsh dhe vajzash shqiptare. Një pjesë e këtyre të rinjve shkuan në Monarkinë Danubiane me mjetet financiare të vendit. Ndërkohë që 25 të rinj të tjerë shqiptarë u dërguan për të studiuar në institucionet e edukimit ushtarak në Vjenë dhe në Budapest.²⁹ Arritje e shënuar për arsimin shqiptar ishte hapja e shkollave fillore shqipe edhe në viset e banuara nga shqiptarët në Kosovë dhe në Mal të Zi³⁰, të cilëve, më parë, u ishte mohuar e drejta për të hapur shkolla në gjuhën shqipe nga ana e autoriteteve serbe dhe malaziase.

* Në dokument nuk saktësohet nëse bëhet fjalë për buxhetin e Këshillit të Ministrave të Hungarisë apo atë të Austro-Hungarisë.

²⁸ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 27-1, Referat i kont Czapary-t për Këshillin e Ministrave të Hungarisë, 1917.*

²⁹ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 27-1-106, Shkresë nr. 119 e Korpskomandës XIX në Shqipëri, drejtuar Kryekomandës së ushtrisë austro-hungareze, Shkodër, 17 janar 1917; “Lajme vendit. Zansa shqyptarë n’Monarkië”, *Posta e Shqypnies*, nr. 87, Shkodër, 6 tetor 1917, 3; “Djelmt shqyptarë n’Kadetenxhule”, *Posta e Shqypnies*, nr. 79, Shkodër, 5 shtator 1917, 3.*

³⁰ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-14-1465, Telegram shifër i përfaqësuesit austro-hungarez në Cetinë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Cetinë 30 shtator 1916; HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-20-2076, Protokoll i mbajtur më 2/II/1917 në pallatin qeveritar dhoma nr. 474 në Cetinë, Mali i Zi.*

Ndërkohë, në Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Vuçiternë [Vushtrri] dhe vende të tjera u hapën shkolla fillore, ku mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën shqipe.³¹ Po kështu, shkolla shqipe u hapën edhe në qytetin e Ulqinit,³² në Tuz dhe Traboin.³³ Në tetor të vitit 1917, autoritetet ushtarake austro-hungareze në Cetinë urdhëruan hapjen e një kursi pedagogjik për mësuesit e rrethit të Pejës. Qëllimi i këtij kursi ishte unifikimi i metodave të mësimdhënies në të gjitha shkollat fillore.³⁴

Krahas hapjes së shkollave, vështrimi i Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, si dhe puna e drejtuesve shqiptarë të arsimit u përqendrua edhe në botimin e teksteve të gjuhës shqipe për shkollat fillore të hapura në Shqipëri dhe Kosovë. Drejtuesit shqiptarë punuan për unifikimin e përmbajtjes dhe të gjuhës së teksteve të shkollave fillore. Tekstet e hartuara gjatë kësaj periudhe nuk kishin përmbajtje fetare, prandaj ato mund të përdreshin nga ana e të gjitha grupeve fetare në vend. Tekstet e botuara apo ato që u bënë gati për botim u mbështetën në dialektin e Elbasanit, sipas rregullores së hartuar nga “Komisia letrare”. Për zhvillimin e arsimit në viset shqiptare u dërguan sasi të konsiderueshme tekstesh shkollore në gjuhën shqipe.³⁵ Këto

³¹ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-15-1565, Raport i Komandës eprorë, drejtuar Guvernatoratit të Përgjithshëm Ushtarak austro-hungarez në Beograd, 10 korrik 1916; HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-17-1798, Shkresë sekrete nr. 25/P e ministrit austro-hungarez Széchenyi, drejtuar baronit Burian, Beograd, 7 tetor 1916.*

³² “Lajme vendit. Shkolla shqype n’Ulqin”, *Posta e Shqypnjes*, nr. 27, Shkodër, 10 mars 1917, 2.

³³ “Lajme vendit. Shkollat n’Malcië t’Madhe”, *Posta e Shqypnjes*, nr. 57, Shkodër, 23 qershor 1917, 4.

³⁴ “Lajme vendit. Kurs pedagogjik n’Pejë”, *Posta e Shqypnjes*, nr. 91, Shkodër, 20 tetor 1917, 4.

³⁵ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-19-1962, Listë e mjeteve mësimore për shkollën shqipe në Mitrovicë, 31 gusht 1916.*

tekste ishin kryesisht për lëndët e abetares dhe gramatikës.³⁶ Për shkak të të drejtave kulturore që fituan shqiptarët, një rritje të kërkesës për tekste shkollore pati nga arsimtarët e shkollave të hapura në Kosovë. Hysni Curri i kërkonte Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, dërgimin e teksteve në gjuhën shqipe për shkollat e hapura në rrethin e Gjakovës.³⁷ Me sa duket, kërkesa për tekste shkollore ishte aq e madhe, sa në gusht të vitit 1916, edhe Guvernatori i Përgjithshëm Ushtarak në Mal të Zi u kërkoi autoriteteve eprore në Vjenë, që të dërgoheshin 6 mijë copë abetare kundrejt pagesës.³⁸

Falë ndihmesës së qeverisë austro-hungareze për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, si dhe në dërgimin e teksteve shkollore, interesimi i shqiptarëve të Kosovës për shkollat në gjuhën shqipe filloi të rritej gjithnjë e më tepër. Ky ishte një faktor i rëndësishëm për zhvillimin arsimor e kulturor të shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve politikë të shtetit shqiptar. Hapja e shkollave fillore në gjuhën shqipe në viset e Kosovës dhe më gjerë ndikoi në forcimin e mëtejshëm të ndërgjegjes kombëtare. Zhvillimi arsimor e kulturor i shqiptarëve gjatë viteve 1916-1918 shërbeu si pikë reference në periudhën e mëvonshme për intensifikimin e përpjekjeve të shqiptarëve që jetonin në Kosovë, Malin e Zi dhe Maqedoni për liri dhe të drejta kombëtare.

³⁶ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-19-1963, Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë “Tekste mësimore për shkollën shqipe në Ferizoviç”, Vjenë, 27 tetor 1916.*

³⁷ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-4-1478, Shkresë nr. 2102 e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë “Mbi librat shkollore për Gjakovën”, Vjenë, 3 maj 1917.*

³⁸ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 26-14-1464, Telegram i përfaqësuesit austro-hungarez në Cetinë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Cetinë, 28 gusht 1916.*

Struktura dhe mënyra e organizimit të shkollave fillore në Shqipëri, rregulloret dhe programet unike mësimore të zbatuara në shkollat e vendit u mbështetën në modelin austro-hungarez, por natyrisht që ato u përshtatën me kushtet e vendit, nga mësuesit dhe njohësit më të mirë të arsimit kombëtar shqiptar. Me sa duket, këto programe rezultuan efikase, përderisa ato vijuan që të përdroreshin në sistemin arsimor të shtetit shqiptar për disa vite pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore.³⁹

Në rrethanat e luftës, por edhe në kushtet e mungesës së përvojës në fushën e arsimit, ky model rezultoi se ishte një zgjidhje e drejtë, pasi nuk kishte se ku të merrej një përvojë më e mirë sesa nga një vend si Austro-Hungaria, me një arsim shumë herë më të zhvilluar se Shqipëria. Mbështetur në përvojën austro-hungareze, drejtuesit e arsimit shqiptar u përpoqën që t'u jepnin shkollave një fizionomi të qartë kombëtare, duke filluar që nga programet shkollore, tekstet mësimore e deri në terminologjinë e përdorur në arsim.⁴⁰

Lidhur me kontributin që dha Austro-Hungaria për zhvillimin e arsimit në Shqipëri gjatë viteve 1916-1918, poeti kombëtar shqiptar, Gjergj Fishta, shkruante se, nëse ideali i shqiptarëve ishte organizimi i Shqipërisë sipas modelit të kulturës perëndimore, Austro-Hungaria bëri më tepër sesa pritej, për ta vënë në jetë këtë aspiratë të shqiptarëve.⁴¹

³⁹ *HHSTA, PA, A, në AIH, Vj. 27-1-109, Raport i konsullit të Përgjithshëm Kral, drejtuar kontit Czernin, Shkodër, 17 qershor 1917; Ilir Kanini, Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore..., 29, 37.*

⁴⁰ I. Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore..., 57.*

⁴¹ Gj. Fishta, "Ushtria austro-ungare e të mkamunt e Shqypnis", *Posta e Shqypniës*, nr. 13, Shkodër, 23 janar 1918, 1.